

# A duhet të pajiseni me licencë për TV?

## Përse mund të ju nevojitet Abonimi për TV?

Ju duhet të pajiseni me Licencë TV pamvarësisht se çfarë pajisje përdorni për të parë apo regjistruar programe të transmetuara nga stacione televizive. Këtu hyjnë televizor, kompjuter, telefon celular, pajisje për lojra elektronike, dekoder të ndryshëm si dhe regjistruer DVD dhe video regjistruer.

Duhet të dini se në rast se kapeni duke parë televizor pa e patur atë aktualisht të regjistruar, ju mund të paditeni në gjykatë dhe të gjobiteni me gjobë që shkon deri në £1,000 stërlina.

Pra, tani ju duhet të paguani për Licencë TV në rast se ju do të shikoni apo regjistroni programe televizive. Për mënyrat e ndryshme të pagesës, lutemi referojuni nën-kapitullit "Si të paguash regjistrimin" që vijon më poshtë.

## Po për programet satelitore jo-të Mbretërisë së Bashkuar?

Edhe në këtë rast ju nevojitet abonim TV, bile edhe në rast se ju arrini të merrni apo regjistroni transmetime nga jashtë Britanisë së Madhe.

## Apo doni të paguani me këste javore?

Në rast se dëshironi të paguani çdo javë Taksën e TV, ju mund të paguani këste javore prej £5.60 pagesë nëpërmjet kartës abonente të TV. Lutemi telefononi në numrin 0300 555 3456.

## Po kur ndërroni banesë?

Në rast se ndërroni banesë dhe aktualisht keni Licencë TV në adresën tuaj të vjetër, lutemi na njoftoni për adresën e re duke hyrë në faqen tonë të internetit [www.tvlicensing.co.uk/moving](http://www.tvlicensing.co.uk/moving) ose duke telefonuar në numrin 0300 790 6044.

## A mund të bëhen përjashtime?

**Në se ju, ose ndokush që banon me ju:**

- **është 75 vjeç e lart?** Ju mund të përfitonit Licencë TV falas. Për këtë duhet të aplikoni ose nëpërmjet faqes sonë të internetit ose duke na telefonuar në numrin 0300 790 6044.
- **74 vjeç?** Ju mund të aplikoni për Licencë TV afatshkurtër, periudhë që do të mbulojë deri ditën që ju të mbushni moshën 75 vjeç.
- **I verbër ose me shikim shumë të dobët?** Ju mund të përfitonit 50% zbritje të tarifës së plotë. Për të aplikuar, vizitoni faqen tonë të internetit ose dërgoni me postë fotokopje të dokumentit që vërteton regjistrimin tuaj si i verbër – ose një konfirmim nga okulisti – së bashku me numrin e Licencës TV tuajën, numrin e telefonit dhe një çek pagese për TV Licensing, Blind Concession Group, Bristol BS98 1TL.

## Kur nuk ju nevojitet Licencë TV?

Ju nuk keni nevojë për t'u pajisur me Licencë TV, në rast se ju nuk shikoni ose nuk regjistroni programe televizive kur ato transmetohen – qoftë nëpërmjet televizorit, kompjuterit, telefon celular, pajisjeve për lojra elektronike, dekodera të ndryshme, pajisje regjistruese DV dhe video ose çdo pajisje tjetër. Lutemi na bëni me dije duke vizituar faqen tonë të internetit [www.tvlicensing.co.uk/noTV](http://www.tvlicensing.co.uk/noTV) ose telefononi në numrin 0300 790 6044.

## Si mund të pajiseni me licencë.

Taksa e regjistrimit për TV me ngjyra është £145.50 stërlina (£49.00 stërlina për TV bardhë e zi). Pagesa mund të bëhet në mënyra të ndryshme – zgjidhni mënyrën më të përshtatshme për ju:



**Në internet.** Mund të paguani me anë të internetit në adresën [www.tvlicensing.co.uk](http://www.tvlicensing.co.uk). Për këtë ju duhen të dhënat e kredit kartës.



**Duke paguar direkt me transfertë nga llogaria juaj bankare.** Ju mund të paguani me pagesa mujore, tre mujore ose vjetore. Për të organizuar pagesën me Debi Direkte mjafton të vizitoni faqen tonë të internetit [www.tvlicensing.co.uk/dd](http://www.tvlicensing.co.uk/dd) ose të na telefononi në numrin 0300 790 6044 duke patur paraprakisht të dhënat e llogarisë suaj bankare.



**Me kartë krediti.** Për të paguar me karta krediti si Maestro, Delta, Solo, Visa, Visa Electron apo MasterCard, lutemi të telefononi në numrin 0300 790 6044. Lutemi kur të telefoni të keni gati të dhënat kartës që do të përdorni.



**Në çdo pikë të PayPoint.** Ju mund të paguani kesh ose me kartë për Abonim TV.



**Me postë.** Mbushni një çek të pagueshëm për 'TV Licensing'. Vini emrin, adresën dhe kodin postar në anën e pasme të çekut dhe postojeni në adresën: TV Licensing, Bristol BS98 1TL. Lutemi mos dërgoni para me postë.

Për çdo pyetje ose ndihmë përsa i përket kësaj fletëpalosje, telefononi në numrin 0300 790 6044.

Në rast se ju keni vështirësi me shikimin, ju mund ta siguronit këtë informacion nëpërmjet imelit ose në formatin Braille, shtypur me shkronja të mëdha ose dhe në audio duke na telefonuar në numrin 0300 790 6076. Po ashtu, pajisje Minicom për personat që nuk dëgjojnë apo kanë vështirësi në dëgjim është i disponueshëm duke telefonuar në numrin 0300 790 6050.

Lutemi të mos harroni se karta kyrsyese e Abonimit në TV tashmë ka zëvendësuar pullat kursuese të Abonimit në TV. Për më shumë informacion lutemi të telefononi në numrin 0300 555 0282.